

Tabela e përputhshmërisë

Acquis së BE-së që synohet të përafrohet (Nr. CELEX, Nr. Natyral, lloji i aktit, institucioni që e ka miratuar, data e miratimit, titulli i plotë dhe numri i Fletores Zyrtare) Direktiva 2014/36/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit datë 26 Shkurt 2014 mbi kushtet e hyrjes dhe të qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta për qëllime punësimi si punonjës sezonal, Numri CELEX 32014L0036, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Serial L, Nr. 94, datë 28.3.2014, faqe 375–390.		Legjislacioni shqiptar i propozuar (titulli i projektaktit) Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.108/2013 “Për te huajt”” Shkalla e përafrimit(një nga tre mundësitë e mëposhtme) në total e projekt-aktit Përputhshmëri e plotë Përputhshmëri e pjesshme I papërputhur				
1	2	3	4	5	6	7
Neni	Teksti	Referenca	Neni	Teksti	Përputhshmëria	Shënime
Neni 3, germa “b”	Me "punëtor sezonal" nënkuptohet një shtetas i vendeve të treta që e ka vendin e tij / të saj kryesor të qëndrimit në një vend të tretë dhe qëndron ligjërisht dhe përkohësisht në territorin e një Shteti Anëtar për të kryer një aktivitet të punës stinore , në bazë të një ose më shumë kontratash pune me afat të caktuar, përfunduar në mes tij dhe punëdhënësit vendosur në shtetin Anëtar;	Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.108/2013 “Për të huajt””	Neni 1, pika 2	2. Pika 9, ndryshohet si më poshtë: “Punëtor stinor” është i huaji i cili e ka vendbanimin e tij kryesor jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, por përkohësisht qëndron ligjërisht në territorin e saj, për të kryer një aktivitet të punës stinore, në bazë të një ose më shumë kontratave të punës me kohë të përcaktuar, të lidhura midis të huajit dhe punëdhënësit, i cili ndodhet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.”	Përputhshmëri e pjesshme	Përafrimi nuk është i plotë pasi Shqipëria nuk është ende anëtar i BE.
Neni 5, pika 4	Në rastet kur kontrata e punës ose oferta e detyrueshme e punës specifikon se shtetasi i vendit të tretë do të ushtrojë një profesion të rregulluar, siç përcaktohet në Direktivën 2005/36 / KE të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (1), Shteti Anëtar mund t’i kërkojë aplikantit të paraqesë dokumentacionin që vërteton se i plotëson kushtet e përcaktuara sipas ligjit kombëtar për ushtrimin e		Neni 24, pika 2	2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë: “2. Në rast se kontrata / oferta e punës e të huajit, përcakton se aktiviteti që do të ushtrojë është një profesion i rregulluar, i huaji duhet të plotësojë kushtet e përcaktuara në përputhje me të drejtën kombëtare të ushtrimit të profesioneve të rregulluara.”	Përputhshmëri e pjesshme	

	profesionit të rregulluar.					
Neni 14 "Kohëzgjatja e qëndrimit"	1.Shtetet Anëtare duhet të përcaktojnë një periudhë maksimale të qëndrimit për punëtorët sezonalë e cila duhet të jetë jo më pak se pesë muaj dhe jo më shumë se nëntë muaj në çdo periudhë 12-mujore. Pas kalimit të kësaj periudhe, shtetasi i vendit të tretë duhet të largohet nga territori i Shtetit Anëtar në fjalë, përveç rasteve kur Shteti Anëtar ka lëshuar një leje qëndrimi sipas të drejtës kombëtare ose të Bashkimit për qëllime të ndryshme nga ato të punës sezonale. 2.Shtetet Anëtare mund të përcaktojnë periudhën maksimale kohore brenda çdo periudhe 12-mujore, gjatë së cilës punëdhënësit i është lejuar të punësojë punëtorë sezonal. Kjo periudhë duhet të jetë jo më pak se periudha maksimale e qëndrimit të vendosur në përputhje me paragrafin 1.		Neni 24, pika 1 (Neni 88, pika 1 e ligjit nr.108/2013 "Për të huajt")	1."Në pikën 1, hiqen fjalët "dhe që të rikthehet në vendin e origjinës pas përfundimit të kontratës së punës". ("1.Të huajt i jepet leje pune si punëtor stinor, me afat deri në gjashtë muaj, për çdo vit kalendarik, për rajone, punëdhënëse, profesione dhe kontratë pune, me afat kohor të përcaktuar.")	Përputhshmëria e pjesshme	
Acquis së BE-së që synohet të përafrohet (Nr. CELEX, Nr. Natyral, lloji i aktit, institucioni që e ka miratuar, data e miratimit, titulli i plotë dhe numri i Fletores Zyrtare) Direktiva 2014/66/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 5 Maj 2014 mbi kushtet e hyrjes dhe të qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta në kuadër të transferimit brenda ndërmarrjes, Numri CELEX 32014L0066, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L 157, datë 27.5.2014, faqe 1-22.		Legjislacioni shqiptar i propozuar (titulli i projektaktit) Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.108/2013 "Për të huajt"" Shkalla e përafrimit(një nga tre mundësitë e mëposhtme) në total e projekt-aktit Përputhshmëria e plotë Përputhshmëria e pjesshme I papërputhur				
1	2	3	4	5	6	7
Neni	Teksti	Referenca	Neni	Teksti	Përputhshmëria	Shënime
Neni 3, germat "b",	b) "Transferimi brenda korporatës" nënkupton dërgimin e përkohshëm për	Projektligji "Për disa	Neni 1, pika 3	3. Pika 11 ndryshohet si më poshtë: "11."Personeli kyç" janë të huajt sipas	Përputhshmëria e	Përafrimi nuk është i plotë pasi

“e”, “f” dhe “g”	qëllime profesionale apo trajnimi të një shtetasi të vendeve të treta i cili në kohën e aplikimit për një leje transferimi brenda-kompanisë, banon jashtë territorit të Shteteve Anëtare, nga një ndërmarrjeje vendosur jashtë territorit të një Shteti Anëtar dhe me të cilën shtetasi i vendit të tretë është i lidhur me një kontratë pune para dhe gjatë transferimit, për një njësi ekonomike që i përket ndërmarrjes ose të të njëjtit grup të ndërmarrjeve e cila është themeluar në atë Shtet Anëtar dhe kur është e zbatueshme, mobiliteti midis subjekteve pritëse themeluar në një ose disa shtete anëtare të dyta; e) "menaxheri" nënkupton një person që mban një pozitë të lartë, i cili në radhë të parë drejton menaxhimin e subjektit pritës, duke marrë mbikëqyrje të përgjithshme ose udhëzime kryesisht nga bordi i drejtorëve ose aksionarëve të biznesit ose ekuivalent; pozicioni do të përfshijë: drejtimin e subjektit pritës ose një departamenti, nënndarje të subjektit pritës; mbikëqyrjen dhe kontrollin e punës së punonjësve të tjerë; autoritetin për të rekomanduar punësimin, shkarkimin ose veprime të tjera në lidhje me personelin. f) "specialist" nënkupton një person që punon në kuadër të grupit të ndërmarrjeve që i posedojnë njohuri të specializuara esenciale për fushat e veprimtarisë, teknikave apo menaxhimit të njësisë pritëse. Në vlerësimin e njohurive të tilla,	shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.108/2013 “Për të huajt”		kategorive të mëposhtme: a)“Vizitorë biznesi” janë personat fizikë, të cilët punojnë në një pozicion drejtues brenda një personi juridik dhe janë përgjegjës për ngritjen e një aktiviteti tregtar. Ata nuk angazhohen në transaksione të drejtpërdrejta me publikun e gjerë dhe nuk marrin shpërblim nga një burim që ndodhet brenda palës pritëse; b) “Të transferuar brenda ndërmarrjes/shoqërisë” janë personat fizikë, të cilët kanë qenë të punësuar nga një person juridik jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë ose kanë qenë ortakë të tij, për gjashtë muaj të pandërprerë, që paraprin menjëherë këtë transferim dhe janë transferuar përkohësisht në një degë të ndërmarrjes/shoqërisë (duke përfshirë departamentet ose sektorët) në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas nënkategorive të mëposhtme: i)“menaxher” nënkupton një person i cili mban një pozicion të lartë dhe drejton menaxhimin e subjektit pritës, merr mbikëqyrje të përgjithshme ose udhëzime kryesisht nga bordi i drejtorëve ose i aksionarëve të biznesit ose; ky pozicion përfshin: drejtimin e subjektit pritës, një departamenti ose nënndarje të tij; mbikëqyrjen dhe kontrollin e punës së punonjësve të tjerë, specialistëve apo menaxherëve; autoritetin për të rekomanduar punësimin, shkarkimin ose veprime të tjera në lidhje me personelin; ii)"specialist" nënkupton një person i cili punon për grupin e ndërmarrjeve/shoqërive, zotëron njohuri	pjesshme	Shqipëria nuk është ende anëtar i BE.
-------------------------	--	--	--	--	-----------------	--

	duhet të merren parasysh jo vetëm e njohurive specifike të subjektit pritës, por edhe nëse personi ka një nivel të lartë të kualifikimit, duke përfshirë përvojën e duhur profesionale që i referohet një lloj pune ose aktiviteteve që kërkojnë njohuri të veçanta teknike, duke përfshirë anëtarësinë e mundshme në një profesion të akredituar; g) "praktikant i diplomuar" do të thotë një person me diplomë universitare i cili është transferuar në një entitet të pritës për qëllime të zhvillimit të karrierës, ose në mënyrë që të marrë trajnime në teknikat ose metodat e biznesit, dhe paguhet gjatë transferimit;			të specializuara, thelbësore për fushat e aktivitetit të njesisë pritëse, teknikave apo menaxhimit. Në vlerësimin e njohurive të tilla, duhet të merren parasysh jo vetëm njohuritë specifike për njësinë pritëse, por edhe nëse personi ka një nivel të lartë të kualifikimit, duke përfshirë përvojën e duhur profesionale referuar një lloji pune ose aktiviteti që kërkon njohuri të veçanta teknike, duke përfshirë edhe mundësinë e pasjes së një profesioni të njohur;” iii)"praktikantët e diplomuar" janë personat fizikë të cilët kanë qenë të punësuar nga një person juridik jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për të paktën 3 muaj të pandërprerë, që paraprin menjëherë këtë transferim, zotërojnë një diplomë universitare dhe janë transferuar përkohësisht në një degë të tij në territorin e Republikës së Shqipërisë, për qëllime të zhvillimit të karrierës apo për t'u trajnuar në metodat/teknikat e biznesit dhe të cilët paguhën gjatë periudhës së transferimit.”		
Neni 5 Kushtet e pranimit	1. Pa cenuar nenin 11 (1), shtetasi i vendit të tretë që aplikon për t'u pranuar sipas kushteve të kësaj Direktive ose subjekti pritës duhet: (a) të japë prova se subjekti pritës dhe ndërmarrja e themeluar në një vend të tretë i takojnë të njëjtit ndërmarrje ose grup të ndërmarrjeve; (b) të sigurojë prova të punësimit brenda të njëjtës ndërmarrje ose grup të ndërmarrjeve, prej të paktën tre deri në dymbëdhjetë muaj pandërprerë menjëherë para datës së transferimit ndër-		Neni 25, pika 1	1.Pika 1 ndryshohet si më poshtë: “1. Të huajt, të cilët transferohen nga një ndërmarrje / shoqëri jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në një degë të saj (duke përfshirë departamentet ose sektorët) në territorin e Republikës së Shqipërisë, duhet të kenë qenë të punësuar për këtë ndërmarrje / shoqëri, për një periudhë; a) gjashtë muaj të pandërprerë, që paraprin menjëherë këtë transferim për kategoritë:	Përputhshmëri e pjesshme	

	korporatave në rastin e menaxherëve dhe specialistëve, si dhe nga të paktën tre deri në gjashtë muaj pandërprerë në rastin e të punësuarve në trajnim; (c) të paraqesë një kontratë pune dhe, nëse është e nevojshme, një letër e caktimit nga punëdhënësi duhet të përmbajë: (i) detajet e kohëzgjatjes së transferimit dhe vendndodhjen e subjektit pritës ose entitetet; (ii) prova se shtetasi i vendit të tretë është duke marrë një pozicion si një menaxher, specialist ose punonjës praktikant në vendin pritës apo subjekteve në Shtetin Anëtar në fjalë;			i) administrator; ii) specialistë; b) tre muaj të pandërprerë, që paraprin menjëherë këtë transferim për kategorinë: i. praktikantë të diplomuar;”		
Acquis së BE-së që synohet të përafrohet (Nr. CELEX, Nr. Natyral, lloji i aktit, institucioni që e ka miratuar, data e miratimit, titulli i plotë dhe numri i Fletores Zyrtare) Direktiva e Këshillit 2009/50/KE, datë 25 maj 2009 “Mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta me qëllim pune tepër të kualifikuar”, Numri CELEX 32009L0050, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, Seria L, Nr. 155, datë 18.6.2009, faqe 17–29.		Legjislacioni shqiptar i propozuar (titulli i projektaktit) Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.108/2013 “Për te huajt”” Shkalla e përafrimit(një nga tre mundësitë e mëposhtme) në total e projekt-aktit Përputhshmëri e plotë Përputhshmëri e pjesshme I papërputhur				
1	2	3	4	5	6	7

Neni	Teksti	Referenca	Neni	Teksti	Perputhshmëria	Shënime
Neni 5, Kriteret e pranimit, pika , germa “a”	1. Pa rënë ndesh me nenin 10 (1), shtetas të vendeve të treta që aplikon për një Kartë Blu të BE-së sipas kushteve të kësaj Direktive: (a) të paraqesë një kontratë të vlefshme pune, ose , siç parashikohet në ligjin kombëtar, një ofertë të detyrueshme të punës për punësim me kualifikim të lartë, të paktën njëvjeçare, në shtetin Anëtar në fjalë;		Neni 27, pika 1	Në germën “a” të pikës 1, fjalët “së paku 2-vjeçare”, zëvendësohen me fjalët “minimale 1 vit”.	Përputhshmëri e pjesshme	
Acquis së BE-së që synohet të përafrohet (Nr. CELEX, Nr. Natyral, lloji i aktit, institucioni që e ka miratuar, data e miratimit, titulli i plotë dhe numri i Fletore Zyrtare)		Legjislacioni shqiptar i propozuar (titulli i projektaktit)				
Direktiva 96/71/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 16 dhjetori 1996 në lidhje me transferimin e punëtorëve në kuadër të ofrimit të shërbimeve, Numri CELEX 31996L0071, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 18, datë 21.1.1997, faqe 1–6.		Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.108/2013 “Për te huajt”” Shkalla e përafrimit(një nga tre mundësitë e mëposhtme) në total e projekt-aktit Përputhshmëri e plotë Përputhshmëri e pjesshme I papërpunur				
1	2	3	4	5	6	7
Neni	Teksti	Referenca	Neni	Teksti	Përputhshmëria	Shënime
Neni 2 Përkufizime	1.Për qëllimet e kësaj Direktive, "punëtor i caktuar" do të thotë një punëtor i cili, për një periudhë të kufizuar, kryen punën e tij në territorin e një shteti anëtar tjetër nga shteti në të cilin ai zakonisht punon. 2. Për qëllime të kësaj Direktive, përkufizimi i një punëtori është ai që aplikohet në ligjin e Shtetit Anëtar në territorin e të cilit punëtori është dërguar.		Neni 1, pika 4	"33.Ofrues shërbimesh kontraktuale" janë personat fizikë të punësuar nga një person juridik jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë i cili ka një kontratë për të ofruar shërbime me një konsumator në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe kërkon praninë e punonjësve të tij, në një degë të përkohshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, në mënyrë që të përmbushë kontratën e ofrimit të shërbimeve.	Përputhshmëri e pjesshme	Përafrimi nuk është i plotë pasi Shqipëria nuk është ende anëtar i BE.

Neni 1, Qëllimi, pika 3	3. Kjo Direktivë do të zbatohet deri në masën që ndërmarrjet e përmendura në paragrafin 1, të marrin një nga masat e mëposhtme trans-nacionale: (a) punëtorët e caktuar në territorin e një Shteti Anëtar në llogarinë e tyre dhe nën drejtimin e tyre, nën një kontratë e lidhur midis ndërmarrjes, duke e bërë caktimin/vendosjen dhe palën për të cilën ofrohen shërbimet, që veprojnë në atë Shtet Anëtar, me kusht që të ketë një marrëdhënie pune mes ndërmarrjes që ka bërë caktimin e këtij punëtori dhe punëtorit, gjatë periudhës së ofrimit të shërbimit; ose (b) punëtorët e caktuar të një ndërmarrje ose në një ndërmarrje në pronësi të grupit në territorin e një Shteti Anëtar, me kusht që të ketë një marrëdhënie punësimi mes ndërmarrjes që ka bërë caktimin dhe punëtorit gjatë periudhës së caktimit; ose (c) duke qenë një ndërmarrje e përkohshme punësimi ose agjenci të punësojë një punëtor në një ndërmarrje përdoruese të krijuar ose që vepron në territorin e një Shteti Anëtar, me kusht që të ketë një marrëdhënie punësimi mes ndërmarrjes së përkohshme të punësimit ose agjencisë dhe punëtorit gjatë periudhës së caktimit/vendosjes.		Neni 30, pika 1	1.Pas pikës 2, shtohen pikat 2/1, 2/2 dhe 2/3, me këtë përmbajtje: “2/1.Ofruesit e shërbimeve kontraktuese, të cilëve i lejohet hyrja për ofrimin e shërbimeve, do t'i nënshtrohet kushteve të përcaktuara më poshtë: (a) Duhet të jenë të angazhuar në ofrimin e një shërbimi në një bazë të përkohshme në Republikën e Shqipërisë, gjatë periudhës së shkëputjes duhet të ekzistojë një marrëdhënie pune midis punonjësit dhe personit juridik jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, i cili ka një kontratë shërbimi me subjektin e regjistruar në Republikën e Shqipërisë. (b) Duhet të kenë të paktën dy vjet eksperiencë në fushën e veçantë, objekt i kontratës së shërbimit. (c) Personat fizikë që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë për të ushtruar një veprimtari në bazë të ligjit, rregulloreve ose kërkesave të palës ku shërbimi ofrohet, duhet të kenë kualifikimet profesionale përkatëse, kur kjo gjë është e nevojshme. (ç) Personat fizikë nuk do të marrin shpërblim për ofrimin e shërbimeve të tjera, përveç shpërblimit të dhënë nga klienti me të cilin punëdhënësi i tij / i saj ka një kontratë për ofrimin e shërbimit. (d) Hyrja e përkohshme dhe qëndrimi i tyre brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, do të jetë për një periudhë jo më shumë se gjashtë muaj në çdo periudhë dymbëdhjetë mujore, ose në përputhje me kohëzgjatjen e kontratës, gjithmonë kur qëndrimi është më pak se gjashtë muaj në çdo periudhë	Përputhsh mëri e pjesshme	Përafrimi nuk është i plotë pasi Shqipëria nuk është ende anëtar i BE.
------------------------------------	---	--	----------------------------	---	---	---

				dymbëdhjetë mujore. (dh) Numri i personave të mbuluar nga kontrata e shërbimit, nuk mund të jetë më i madh se sa është e nevojshme për të përmbushur kontratën. Ky numër mund të përcaktohet nga ligjet, rregulloret dhe kërkesat e palës ku shërbimi do të ofrohet.”		
--	--	--	--	---	--	--